DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 43-1651/5
-VI- Data Datum Date 20.07.2018

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt<br>Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt | |
| Kopje | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Shkëlqim Jakupi , Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL | Datë: 16/07/2018<br>Nr. 043/1651/4 |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë se aktit të komunës së Skenderajt | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 01-110/05-0037966/18 për plotësim-ndryshimin e rregullores nr.01/110-6347 të datës 01.12.2016 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba |
| I miratuar më datë më datë: 29.06.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.07.2018 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| **Nr.** | **Formulimi në aktin e komunës** | **Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.** |
|---|---|---|
| 1. | Vendim Nr. 01-110/05-0037966/18 për plotësim-ndryshimin e rregullores nr.01/110-6347 të datës 01.12.2016 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba | Vendimi Nr. 01-110/05-0037966/18 është në kundërshtim me Rregulloren (MAPL) nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin të Akteve të Komunës për arsye të shkeljeve procedurale *"duke bërë plotësim-ndryshim e rregullores me vendim"*. Në nenin 12 të Rregullores se MAPL-së nr.01/2017 është përcaktuare se *"Shfuqizimi, plotësim-ndryshimi i një akti normativ të komunës bëhet nga akti i njëjtë duke respektuar procedurat ligjore"*. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 43-1651/5
-VI- Data Datum 20.07.2018

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | Bekim Jashari, gradonačelnik Opštine Srbica<br>Fatbardha Haliti, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MAPL-sa 29.8.4.<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-u. | |
| Od: | Shkëlqim Jakupi, direktor Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS | Datum, 16.07.2018. Br.043/1561 |
| Predmet: | Zahtev za reviziju zakonitosti akta Skupštine opštine Srbica | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovana predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 01-110/05-0037966/18 ua dopunu i izmenu Pravilnika br.01/110-6347 od dana, 01.12.2016. godine za takse, tarifa i kazne. |
| Usvojena dana, 29.06.2018. godine, |
| Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 10.07.2018. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je akt opštine u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministartsvo administracije lokaklne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

U nastavku ćete naći neusklađenost predloženog akta opštine za razmatranje zakonitosti kao u nastavku:

| Br. | Formulisanje u aktu opštine | Zakonska odredba sa kojom jje akt opštine u suprotnosti. |
|---|---|---|
| 1. | Odluka br. 01-110/05-0037966/18 ua dopunu i izmenu Pravilnika br.01/110-6347 od dana, 01.12.2016. godine za takse, tarifa i kazne. | Odluka br. 01-110/05-0037966/18 je u suprotnosti sa Uredbom MALS-a br. 01/2017 za proceduru izrade i objavljivanja akata opštine zbog proceduralnih kršenja " *vršeči dopunu i izmenu pravilnika odlukom* " u članu 12 Uredbe MALS-a, br.01/2017 je definisano da: "*Ukidanje, dopuna i izmena jednog normativnog akta opštine vrši se istim aktom uz poštovanje zakonskih postupaka*". |

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave, od Skupštine opštine i gradonačelnika traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog vremenskog roka od 30 dana od dana prijema zahteva za razmatranje akta. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za dalja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

02-400/04-0037965/18
09.07.2018

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Kuvendi i Komunës** / Skupština Opštine / Municipal Assembly

Pas shqyrtimit të Projekt - Rregullores nr. 02-400/04-0033397/18, i datës 13.06.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr. 01-110-6347 i datës 01.12.2016, në bazë të nenit 12 paragrafi 1dhe 2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/ 2008), nenit 2, 4 dhe 8 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/L-049, dhe në bazë të nenit 14, paragrafi 1 dhe 2, shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datën 29.06.2018 e miratoi këtë:

PRANIMI / PRIJEM / INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
10.07.2018
-01- 93-1654/4

# V E N D I M

## PËR PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 01-110-6347, E DATËS 01.12.2016, PËR TAKSA,TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA PËR VITIN 2018, KOMUNA E SKENDERAJT.

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, nr. 01-110-6347, e datës 01.12.2016, e Komunës së Skenderajt, për vitin 2018

**Neni 2**

Me këtë Rregullore ndryshohen dhe plotësohen nenet si në vijim: Neni 4 paragrafi 4.1 i rregullores bazë, riformulohet, neni 4 paragrafi 4.3.0 riformulohet, neni 4 paragrafi 4.3.1 riformulohet, neni 4, paragrafi 4.4.2 riformulohet, neni 4 paragrafi 4.4.3 riformulohet, neni 6 pas paragrafit 6.6 shtohet paragrafi 6.7, neni 7 paragrafi 7.3 riformulohet, neni 8 paragrafi 1 riformulohet, neni 9 ndryshohet, dhe shtohet paragrafi 4, neni 10 paragrafi 13 dhe 13.1 riformulohet, neni 12 shtohet dhe riformulohet, neni 12 paragrafi 3 ndryshohet, nenit 12 i fshihen paragrafi 4.4.1, 4.2 dhe 4.3, paragrafi 5 i këtij neni ndryshohet, neni 13 fshihet një pjesë e tekstit dhe i shtohen tabelat 1,2,3,4, neni 14 i shtohet fjali, neni 15 riformulohet pikat 2,3 dhe 4 të tabelës, riformulohen, shkronja i) riformulohet.

**Neni 3**

Zbatimin e kësaj Rregulloreje është e obliguar ta bëjë Drejtoria për Financa, Ekonomi, dhe Zhvillim, Komuna Skenderaj.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit te MAPL-së dhe publikimit në gjuhet zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**Kopje për:**

1. Arkivit të komunës,
2. MAPL-së,
3. DFEZH-ja,
4. Zyrës së Kryetarit,
5. Dosjes.

**Kryesuesja e KK-së:**
**Znj Fathardha Haliti**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracije
Ministry of Local Government Administration
Datum: 10.07.2018
-VI- 43-1651/4

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-MAS-003796/18
09.07.2018

**Kuvendi i Komunës Skenderaj**
Opštine Skupština Skenderaj
Municipal Assembly

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/ Municipality Assembly

Posle razmatranja nacrt-pravilnika br. 02-400/04-0033397/18 od dana 13.06.2018. za izmenu i dpunu Pravilnika za takes, terife, zaduženja i kazni br. 01-110-6347 od dana 01.12.2016 godine, na osnovu člana 12, stav 1 i 2, slovo c) Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040 (, Službeni List Republike Kosova br. 28/2008)člana 2.4. i 8Zakona o Finansiranju Lokalne Samouprave br. 03/L-049, na osnovu člana 14, stav 1 i 2, slovo c) Statuta Opstine Skenderaj/Srbica br. 01-110-385 od dana 03.12.2008 godine, donosi sledeću:

## O D L U K U

## O IZMENI I DOPUNI PRAVILNIKA BR. 01-110-6347, OD DANA 01.12.2016, ZA TAKSE, TARIFE, ZADUŽENJA I KAZNI ZA 2008 GODINU – OPŠTINA SKENDERAJ/SRBICA

### Član 1

Usvaja se odluka za izmenu i dopunu Pravilnika za takse, tarife, zaduženja i kazni, br. 01-110-6347 od dana 01.12.2016, Opština Skenderaj/Srbica za 2018 godine.

### Član 2

Ovim Pravilnikom izmene i dopune sledeći članovi: Član 4, stav 4.1. osnovnog pravilnika reformulira se, Član 4, podstav 4.3.0, reformulira se, član 4, podstav 4.3.1, reformulria se, član 4, podstav 4.4.2 reformulira se, član 4, podstav 4.4.3 reformulira se, član 6, stav 6.6, dodaje se stav 6.7, član 7 stav 7.3 reformulira se, član 8, stav 1 reformulira se, član 9 izmenjuje, i dodaje se stav 4, član 10, stav 13, i 13.1, reformulira se, član 12 oddaje i reformulira se, čla 12 stav 3 izmeni se, članu 12 brišu podstav 4.4.1, stav 4.2 i 4.3, stav 5 ovog člana izmenjuje se, član 13 briše se jedan deo teksta i dodaju se pregledi 1.2.3.4., člana 14, oddaje se rečenica, član 15 reformulira se , tačke 2.3 i 4 pregleda reformuliraju se.

### Član 3

Sprovođenje ovog pravilnika je dužna sprovoditi Direkcija za Finsije, Ekonomiju i Razvoj, opštine Skenderaj.

### Član 4

Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle registracije u kancelariju protokola MALS-a i neb stranicu u oba službena jezika.

**Odluka se dostavlja:**
1x1 Arhivi Opštine;
1x1 MALS-u;
1x1 Kabinetu predsednika;
1x1 Dosiju.

**Presedavajuća SO-a:**
g.đa. Fatbardha Haziri

01-110/05-0037780/18
02.07.2018

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date

DOKUMENTI: RREGULLORJA PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORES KOMUNALE
PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA
2018

2018

**Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c), të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, nenit 2, nenit 10 dhe 13 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/L-049, nenit 14 paragrafi 1 dhe 2, shkonja c) e Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, e datës 03.12.2008, Kuvendit i Komunës së Skenderajt, ne mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.06. 2018, miratoi këtë:**

# RREGULLORE
## PËR PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 01-110-6347, E DATËS 01.12.2016, PËR TAKSA,TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA PËR VITI 2018, KOMUNA E SKENDERAJT.

### Neni 1

1. Neni 4, paragrafi 4.1 i rregullorës bazë, riformulohet me tekstin në vijim: "Obligues për taksën në biznes janë të gjitha biznesët dhe organizatat e ndryshme, që ushtrojnë veprimtarinë bazë, kanë njësi punuese, dhe janë të shtrira brenda territorit të Komunës, që me infrastrukturën e ndërtuar, nga mjetet buxhetore Komunale, mundëson kushte normale për zhvillimin e veprimtarisë formale".
2. Neni 4, paragrafi 4.3.0 i rregullorës bazë, riformulohet me tekstin në vijim: Taksa-paguesi ka të drejtë të bëjë ankesë sipas nenit 5 paragrafi 5.1 dhe 5.2 të kësaj rregulloreje, per taksën në biznes, të faturuar për vitin konkret, në rast së është i pa kënaqur me lartësinë e taksës.
3. Neni 4, paragrafi 4.3.1 i rregullorës bazë, riformulohet me tekstin në vijim: "Taksa-paguesi në rast së do të ndërprejë ushtrimin e veprimtarisë afariste, përkohësisht apo përherë është i obliguar që menjëherë të informoj me shkrim. (kërkesë) Inspektorët financiarë në Drejtorinë për Financë, Ekonomi e Zhvillim, në të kundërtën do te mbetet i ngarkuar deri ne parashtrimin e kërkesës. Taksa-paguesi, paraprakisht, obligohet të kryej të gjitha obligimet e pa kryera para se t'i mbyllet veprimtaria e biznesit me kërkesën e tij".
4. Neni 4, paragrafi 4.4.2 i rregullorës bazë, riformulohet me tekstin në vijim:"Nga taksa komunale, për vitin 2018, Erohen të gjitha bizneset, pervec:

   Kompanitë e Sigurimeve,

   Bankat Komerciale.

Kompanitë për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike,

Sherbimet Postare,

Lojrat e Fatit,

Bastet Sportive,

Njësitë – përfaqësitë të ndryshme financiare"

5. Neni 4, paragrafi 4.4.3 i rregullorës bazë, riformulohet me tekstin dhe tabelen në vijim:"Për veprimtaritë e më sipërme, ngarkesa për vitin 2018, bëhet sipas shumës në tabelën vijuese:

Lista e Bizneseve që propozohen për ngarkesë me taksë komunale vjetore për vitin 2018

*Tabela I*

| Nr R | O B L I G U E S I T *(Bizneset sipas veprimtarisë)* | *Në euro* 2018 |
|---|---|---|
| I | *VEPRIMTARITE BANKARE DHE SIGURIMET* | |
| 1 | *Bankat dhe Kompanitë e sigurimeve* | 1500.00 |
| 2 | *Njesitë bankare* | 500.00 |
| 3 | *Njesitë tjera mikrofinanciare* | 250.00 |
| 4 | *Njesitë e kompanive të sigurimeve* | 250.00 |
| 5 | *Perfaqesitë e Kompanive të jashtme financiare* | 250.00 |
| 6 | *Veprimtaritë tjera financiare* | 200.00 |
| | | |
| II | *NDERMARRJET PUBLIKE - KONCESIONARE* | |
| 1 | *Kompania Kosovare per Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike (KESKO KEDS)* | 2,000.00 |
| 2 | Shërbimet Postare | 1,500.00 |
| | | |
| II | *VEPRIMTARITE E REKREACIONIT* | |
| 1 | *Lotëria e fatit* | 500.00 |

| | | |
|---|---|---|
| 2 | *Veprimtaritë e basteve sportive* | 500.00 |

| | |
|---|---|
| Vërejtje: | *Me qëllim të ruajtjes së zejeve të vjetra tradicionale, orëndreqës, kepucëtar, farkëtar,poçarin, çeleshepunuesit e të ngjajshme lirohen nga taksa vjetore komunale dhe ne te ardhmen do të shqyrtohet mundësia financare e subvencionimit te tyre.* |

Neni 2

1. Nenit 6 të rregullorës bazë, pas paragrafit 6.6 shtohet paragrafi 6.7 me tekstin në vijim:" Nga tarifa për automjete pika a) - lirohen familjarët e deshmorëve, Invalidët e luftës (vetura personale), familjarët e të zhdukurve, dhe përsonat e hendikepuar. Keto kategori kanë të drejtë të lirohen për një (1) veturë pa pagesë të tarifes komunale në përputhshmëri me Ligjin Nr.04/L-054."
2. Neni 7, paragrafi 7.3 i rregullorës bazë, riformulohet me tekstin në vijim:" Nga taksa për shërbimet e mësipërme (pika 7.1 dhe 7.2) lirohen studentët (si dëshmi merret dokumenti identifikues, vërtetimi apo kartela e studentit, fotokopje)"

Neni 3

1. Nenit 8, paragrafi 1 bashkë me tabelen nr.1 të rregullorës bazë, riformulohet me tekstin dhe tabelen në vijim:"

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

1. Tarifat në sferën e bujqësisë, blegtorisë dhe pylltarisë

NDËRRIMI I DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

| Nr. | Emërtimi i kategorisë së tokës | Vlera |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Kategoria e tokës \klasë e I-IV | 0.80 € \ m² |
| 2. | Kategoria e tokës \ klasë e V-VI | 0,50 € \ m² |
| 3. | Kategoria e tokës \ klasë e VII-VIII | 0.50 € \m² |

2. DHËNIA E PËLQIMEVE, VËRTETIMEVE NGA LËMI I BUJQËSISË DHE PASURIVE TJERA BUJQËSORE

| Nr. | Kategorizimi i dokumentit | Vlera |
|---|---|---|
| 1. | Fletëpagesa për damkosje të druve në pyje private me v=7m3<br>mbi 7m3<br>Fletëpagesa për pyje publike- dru të thata-holla d=7cm<br>Fletëpagesa për pyje publike-dru të thata- trasha mbi d=7cm | 1.5 €\m3<br>2 € \m3<br>11 €\m3<br>15 €\m3 |
| 2. | Vërtetim për bujqësi- për rregullimin e vizave turistike | 5.00 € |
| 3. | Eliminimi i qenve endacak dhe shtëpiak me kërkesë të pronarit | 15,00 € |
| 4 | Sistemi i identifikimit të tokës bazuar në ortë-foto ( LPIS ) | 3.00 € |
| 5 | Certifikatë për regjistrimin e fermerit për herë të parë<br>(Fermerët që kërkojnë certifikatën egzistuese, kopie) | 5.00 €<br>1.00 € |
| 6. | Aneks – formulari për aplikim për pagesa direkt për kafshë ( lopë, dele, dhi dhe bletë ) | 3.00 € |

Neni 8 tabela 2 të gjitha familjet e dëshmorëve të Komunës së Skenderajt lirohen nga pagesat e këtyre tarifave nga numri 1,2,4,5,dhe 6 Bazuar në ligjin Nr.04/L-054.

Neni 4

1. Nenit 9 i rregullorës bazë, pika 3 të tabele, shuma nga 15 (pesëmbëdhjetë) euro ndryshohet në 10 (dhjetë) euro. Dhe në fund të tablës shtohet teksti në vijim:" Neni 9 tabela 1 të gjitha familjet e

dëshmorëve të Komunës së Skenderait lirohen nga pagesat e këtyre tarifave nga numri 1 deri në 9. Bazuar në ligjin Nr.04/L-054.".

2. Neni 9 i rregullorës bazë I shtohet paragrafi 4 me tekstin në vijim:"

Mënyra dhe afatet e pagesës

4.1 Pagesa e taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukturë sipas kësaj rregulloreje, e cila tejkalon shumën prej 35.000.00 € mund të bëhet në tri këste, të përshkruara si më poshtë:

a. kësti i parë,pagesa prej 40%,
b. kësti i dytë,pagesa prej 30%,
c. kësti i tretë,pagesa prej 30%.

4.2 Afati për përmbushjen e obligimit të përcaktuar sipas pikës 4,do të jetë 12 muaj.

4.3 Fillimi i afatit prej 12 muajsh sipas pikës 4, do të trajtohet dita e marrjes në dorëzim të lejës se ndërtimit.

4.4 Pagesa e taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukturë sipas kësaj rregulloreje, e cila tejkalon shumën prej 120.000.00 € mund të bëhet në katër këste, të përshkruara si më poshtë:

a. kësti i parë,pagesa prej 30%,
b. kësti i dytë,pagesa prej 25%,
c. kësti i tretë,pagesa prej 25%,dhe
d. kësti i katërtë,pagesa prej 20%.

4.5 Afati për përmbushjen e obligimit të përcaktuar sipas pikës 4.4,do të jetë 18 muaj.

4.6 Fillimi i afatit prej 18 muajsh sipas pikës 4.4. do të trajtohet dita e marrjes në dorëzim të lejës së ndërtimit.

4.7 Rrjedhja e afatit për pagesën e taksës sipas kësaj pike të kësaj rregulloreje fillon ditën e parë pas marrjës në dorëzim të vendimit për llogaritjën e taksës përkatese dhe nuk mund të jetë me gjatë se 5 ditë pas marrjës së aktvendimit për taksa.

4.8 Kest i parë sipas pikës 4.1 dhe 4.4.do të paguhet brenda afatit të parapare sipas pikës 4.7. Bashkë me pagesen e këstit të parë aplikuesi i lejes së ndërtimit është i obliguar që organit kompetent t'i prezantojë garancinë financiare me të cilën sigurohen pagesat e-- kësteve të mbetura për pagesë, sipas afateve të përshkruara ne pikën 4.1 dhe 4.4.

4.9 Vendimi për leje ndërtimi nuk mund të jepet në dorëzim pa proven mbi pagesen e kompenzimit të llogaritur e të arritur për pagesë dhe të garancisë financiare. Sipas
paragrafit 4.7 do të pasoj refuzimimi kërkesës për dhenjën e lejës së ndërtimit.

4.11 Rishqyrimi dhe ushtrimi i mjetit juridik në Vendimin mbi llogaritien e taksës sipas kësaj rregulloreje, nuk e shtynë afatin për pagesë, e as nuk i ndalon veprimet e organit të parapara në pikën 4 të kësaj rregulloreje.

4.12 Për aplikuesit të cilëve ju miratohën kërkesat për leje të ndërtimi kjo shumë do të jetë pjesë e taksës administrative për dhënien e lejës së ndërtimit, ndërsa aplikuesëve të cilëve ju refuzohet kërkesa, kjo taksë nuk do të ju kthehet pasi që organi krijon shpenzime në shqyrtim të aplikacionit.

Neni 5

1. Neni 10, paragrafi 13 dhe 13.1 i rregullorës bazë, rirmulohet me tekstin në vijim:"
"13 Lirohen nga pagesa e tarifës për vërtetime dhe certifikatë të pronësisë rastet sociale;
Si dhe të gjitha familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës të Komunës së Skenderajt lirohen nga pagesat e ketyre bazuar në Ligjin Nr.04/L-054.
13.1 Për t'u liruar nga pagesa nevojitet dëshmia ( kartoni ) nga qendra për punë sociale ,certifikata e deshmorëve dhe invalidëve të UÇK-së".

Neni 6

1. Nenit 12 të rregullorës bazë, pas fjalisë:"Të hyrat nga qiradhënia e pronës së paluajtshme të komunës" i shtohet togëfjalëshi:"së Skenderajt".

2. NË nenin 12 të rregullorës bazë, fshihet teksti në vijim:" Duke u mbështetur në nenin 20 paragrafi 1 dhe 4 të ligjit Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal në vijim paraqesim tarifat për shfrytëzimin e përkohshëm me qira të pronës komunale. Dhe paragrafi 1, 1.1 dhe 2. Të po këtij neni.

3. Neni 12, paragrafi 3 i rregullorës bazë, tabela (B) ndryshohet me sa vijon:

Për pategorinë: Shfrytëzimi i tokës në qendrën e bashkësisë lokale, tarfia nga 3.00, ndryshohet në 1.50 € / m² në vit.

Për pategorinë: Shfrytëzimi i tokës jashtë qendrës nëpër fshatra, tarfia nga 2.00, ndryshohet në 1.00 € m² në vit.

4.Nenit 12 të rregullorës bazë i fshihet paragrafet 4, 4.1, 4.2 dhe 4.3.

5. Nenit 12 të rregullorës bazë, paragrafi 5, për lokalet me qira deri deri në 1 ( një ) vit, tarifa nga 1.50, ndryshon në 4.00 m² në muaj, zona nr.1.

6. Nenit 12 të rregullorës bazë, paragrafi 5, për Lokalet me qira mbi 1 ( një ) vit sipas procedurës konkuruese të hapur, tarifa nga 2.00, ndryshohet n1 5.00/ m² në muaj, Zona nr. 1.

Neni 7

1. Në nenin 13 të rregullorës bazë,  në tabelën me titull: Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në shërbimet QKMF-së, i fshihet kategoria:"Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsultimi i mjekëve".
2. Në fund të nenit 13 të rregullorës bazë shtohet fjalia:" Nëni 13 tabelat 1,2,3,4: të gjitha familjet e dëshmorëve të Komunës së Skenderajt lirohen nga pagesat e këtyre tarifave. Bazuar në Ligjin Nr.04/L-054."
3. Në fund të nenit 14 të rregullorës bazë shtohet fjalia:" Nëni 14 tabela 1: të gjitha familjet e dëshmorëve të Komunës së Skenderajt lirohen nga pagesat e këtyre tarifave. Bazuar në Ligjin Nr 04/L-054",
4. Në nenin 15 të rregullorës bazë, pika 2 e tablesë riformulohet me tekstin në vijim:" Shfrytëzimi i sistemit të zërimit dhe ndriçimit Veshjet e valletareve dhe veshjet kombëtare".

5. Në nenin 15 të rregullorës bazë, pika 3 e tablesë riformulohet me tekstin në vijim:" Për fushata mitingje dhe çdo aktivitet tjeter të partive politike, pa zërim dhe ndriçim".
6. Në nenin 15 të rregullorës bazë, pika 4 e tablesë riformulohet me tekstin në vijim:" Për fushata mitingje dhe çdo aktivitet tjeter të partive politike".

Neni 8

1. Nenit 15 të rregullorës bazë, pika (i) riformulohet me teksti në vijim:"
Dënimi mandator prej 20 ë nëse:

- Nëse subjekti afarist nuk i ven çmimet në vend të dukshëm , nuk u dorëzon blerësve fatura ose nuk e ve firmën në vend të duhur.
- Punëtori i cili punon në lokal nuk e ka uniformën përkatëse dhe nuk ka pastertinë e duhur si dhe .
- Për parregullsitë tjera të konstatuara nga inspektorët: Hudhja e mbeturinave jo adekuate (jasht kontinjerit).
- Hudhja e mbeturinave inerte (të ngurta) jasht vendit të caktuar denohet me gjobë prej 100.00 Euro.
- Hudhja e mbeturinave në vende: fusha dhe sheshe publike denohet me gjobë prej 30.00 Euro.
- Ekspozimi i produkteve të ndryshme në diell (ushqimore dhe joushqimore) jashtë lokalit afarist denohet me gjobë prej 50.00 Euro.

Neni 9

Kjo Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. nr. 01-110-6347, e datës 01.12.2016, e Komunës së Skenderajt, për vitin 2018, hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Skenderaj 2018

Kryesuesja e KK:
znj. Fatbardha Haliti